



Pranuar / Dorëzuar Prijmljenol/Prodato Received/Delivery	13.04.2022	2	viti godina year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMYSHC/K	2076/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.188/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.188/2022 të datës 01.03.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi:

në çështjen juridike “*vlerësim i rezultateve në punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 13.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. SHFUQIZOHET Formulari i Vlerësimit të Rezultateve në Punë i ankuseses për vitin 2021 i datës 31.01.2022
- II. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit ta *rishqyrtojë* rastin e ankuseses në pajtim me legjislacionin në fuqi, njëherit të bëjë *ri-vlerësimin* e rezultateve në punë.
- III. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsy e t i m

Ankuesja, sipas shkresave të lëndës e punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, e pa kënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 më datë 01.03.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës kundër Formularit për Vlerësimin e Punës për vitin 2021 të datës 31.01.2022 me pretendimet ankimore së vlerësimi i bërë nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës me datë 08.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa kjo e fundit me datë 18.03.2022 përmes Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses të datës 01.03.2022 me Nr.Prot:1072/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 28.02.2022 dërguar nga ankuesja në Këshill; Shkresën e datës 08.03.2022 e dërguar nga ankuesja nëpërmjet e-maili e protokolluar me numër:1228/2022 me korrespondencën e bashkangjitur katër (4) faqesh; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 27.01.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 31.01.2022; Formulari për caktimin e objektivave për vitin 2021 i datës 08.01.2021; Raportin përshkrues për vitin për periudhën janar-dhjetor 2021; E-mailin e datës 27.01.2022 dërguar nga ankuesja për ministren e MASHT; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 e datës 31.12.2020; Planin vjetor të inspektoratit të arsimit për vitin 2021 i datës 29.12.2020; Planin vjetor të inspektoratit të arsimit për vitin 2021 i datës 08.01.2022; E-mailin e datës 24.11.2021 dërguar nga ankuesja për ministren e MASHT; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.03.2022; Përgjigjen në kërkesë e datës 18.03.2022 me numër prot:1439/2022 me përmbajtje prej 1/28 faqesh; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Inspektore e arsimit në departamentin e Inspektionit; Akt emërimit të ankueses të datës 02.04.2021; E-mailin e datës 25.11.2021 dërguar nga Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë për ankuesen; E-mailin e datës 17.01.2022 dërguar nga ankuesja për Shkresën e datës 18.03.2022 me numër prot:1441/2022 me provat e bashkangjitura shtesë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ekziston baza ligjore që lënda e ankueses të kthehet në *rishqyrtim*, duke e obliguar Drejtorin e Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit që të bëjë ri-vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 për ankueses *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja sipas aktit të emërimit të datës 02.04.2012 mbanë pozitën "*Inspektore e Arsimit*" në Departamentit të Inspektionit të Arsimit në kuadër të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa në bazë të formularit për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 me datë 31.01.2022 nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt është vlerësuar me notë të përgjithshme tre (3).

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë dhe besueshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 nga Udhëheqësi i saj i Drejtpërdrejtë është bërë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik, në kërkesën për përgjigje në ankesë e protokolluar me numër:1233/2022 të datës 08.03.2022, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ndër të tjera, ka kërkuar: *“Shkresën me përcaktimin e Objektivave të punës për ankuesen gjatë vitit 2021; si dhe Dëshmi me shkrim nëse ndonjëherë gjatë vitit 2021 udhëheqësi i ankueses ka kërkuar performancë më të mirë, evitim të lëshimeve apo sygjerim në arritjen e objektivave”,* ndërsa Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë përmes shkresës së datës 18.03.2022 të nënshkruar nga udhëheqësi i ankueses, njëherit Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit kanë kthyer përgjigje, mirëpo nuk kanë arritur të dëshmojnë me fakte se cilat kanë qenë realisht objektivat punës së ankueses për vitin 2021 për të cilat janë pajtuar ankuesja me udhëheqësin e saj siç përcaktohet me nenin 6 paragrafi 1, 3 dhe 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: *“1. Brenda muajit Janar të vitit për të cilin bëhet vlerësimi i rezultateve në punë apo brenda tre (3) muajve të parë të emërimit të nëpunësit, mbikëqyrësi (vlerësuesi) së bashku me nëpunësin (i vlerësuar) përcaktojnë dhe pajtohen me objektivat dhe me planin e aktiviteteve për arritjen e objektivave të përcaktuara për vitin për të cilin vlerësohet; 3.Objektivat dhe plani i aktiviteteve për arritjen e objektivave përcaktohen me shkrim sipas afateve në paragrafin 1 të këtij neni dhe vendosen në formularin e vlerësimit (Formularin 1) si dhe shërbejnë si bazë për vlerësimin vjetor të nëpunësit. Formularin 1 është shtojcë dhe pjesë përbërëse e kësaj Rregullore. 4. Përcaktimi i objektivave, bazohet në objektivat e institucionit dhe në përshkrimin përkatës të punës së nëpunësit”.*

Po ashtu, Kolegji me përgjigjen e datës 18.03.2022 nuk ka pranuar fakte të provueshme se gjatë vitit kalendarik 2021 ankuesja të ketë pranuar ndonjë kërkesë nga udhëheqësi i saj më qëllim të rritjes së performancës, evitim të lëshimeve apo sygjerime në arritjen e objektivave, përveç e-mailit të datës 25.11.2022 dërguar nga udhëheqësi për ankuesen me kërkesën se deri me datë 06.12.2022 duhet të dorëzohet dokumentacioni i kërkuara, si në vijim: *“Planifikimi vjetor i punës për vitin 2021; Raporti i punës tekstual dhe shifror për vitin 2021; Një kopje të shkresave, përgjigjeve, të gjitha procesverbalet e hartuara nga Ju të renditura sipas datës, të nënshkruara dhe protokolluara (jo vetëm të nxjerrë nga kompjuteri); Vendimet sipas datës dhe numrit të protokollit; Inicime të ndryshme si në polici, prokurori, gjykatë”,* andaj mbi këtë bazë Kolegji ka konstatuar se udhëheqësi i Drejtpërdrejtë i ankueses nuk i ka përmbushur obligimet mbikëqyrëse siç përcaktohet me nenin 7 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: *“Mbikëqyrësi, së paku një herë gjatë periudhës vlerësuese dhe/ose sa herë që vlerëson të nevojshme, zhvillon takime me nëpunësin për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe sjelljet profesionale si dhe për dhënien e sugjerime për përmirësim të nevojshme”,* ndërsa e-maili i datës 25.11.2021 ka pasur karakter raportues dhe evidentim të punëve të kryera nga vartësit e tij me qëllim të vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 dhe nuk e përmbush kriterin e përcaktuar si në nenin 7 të kësaj rregullore.

Kolegji ka analizuar formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të ankuese për vitin 2021 i datës 31.01.2022 dhe ka gjetur se ankuesja për objektiva është vlerësuar me notë tre (3) dhe po ashtu edhe për sjellje profesionale është vlerësuar me notë tre (3), ndërsa nota e përgjithshme tre (3), andaj lidhur me këto të gjetura Kolegji ka konstatuar se udhëheqësi i drejtpërdrejtë me rastin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesen, respektivisht përcaktimit të notës mesatare nuk ka

zbatuar më plotni udhëzimet e rregullores të përcaktuara si në nenin 10 paragrafi 1 dhe 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: *"1. Vlerësimi për arritjen e objektivave të punës përbën 60% të rezultateve përfundimtare të vlerësimit, ndërsa vlerësimi i sjelljeve profesionale të nëpunësve civilë përbën 40% të rezultateve përfundimtare të vlerësimit; 4. Nota e përgjithshme kalkulohet duke mbledhur 60% (shumëzuar me 60 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të objektivave dhe 40% (shumëzuar me 40 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të aftësive"*, ngase sipas vlerësimit mesatar për objektiva me notë tre (3) dhe atij për sjellje profesionale tre (3), si notë e përgjithshme del nota gjashtë (6), notë e cila nuk është e përcaktuar në kategoritë e vlerësimit të shërbimit civil, andaj formula e përdorur nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses është konfuze dhe e pa përcaktuar me rregulloren e lart cekur. Po ashtu, ankuesja me rastin e parashtrimit e ka sjellë edhe formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 27.01.2022 sikurse edhe ai i datës 31.01.2022 në asnjërin rast udhëheqësi i drejtpërdrejtë nuk ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 8 paragrafi 4 i ku përcaktohet se: *"Formulari i vlerësimit siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni i dërgohet nëpunësit, i cili diskutohet në një takim me mbikëqyrësin dhe në afat prej 5 dite kalendarike nëpunësi duhet të shprehet (pajtohet ose nuk pajtohet) me vlerësimin e mbikëqyrësit"*, pasi që Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë i ankueses nuk ka arritur ta dëshmojë se ka vepruar në këtë mënyrë duke e njoftuar ankuesen me vlerësimin të paktën 5 ditë përpara se të përfundojë afati i fundit për vlerësime që sipas nenit 8 paragrafi 2 i së njëjtës rregullore është e përcaktuar: *"Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin paraprak"*.

Andaj, pas vlerësimit të provave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, pas analizimit të dispozitave ligjore në fuqi, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, si dhe në bazë të gjeturave të pasqyruara si më lartë në këtë vendim, Kolegji ka ardhur në përfundimin se ekziston baza e mjaftueshme ligjore sikurse edhe fakte dhe prova konkrete së lënda e ankueses duhet të kthehet në ri-shqyrtim me qëllim të ri-vlerësimit të ankueses tek Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë i ankueses, pasi që i njëjti nuk ka arrit ta zbatojë në plotni nenin 43 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarë Publikë ku përcaktohet se: *"Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues"*, ku parashihet se vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm dhe zgjat për tërë vitin kalendarik në kuptim që nëpunësit të cilat nuk kanë performancë të mirë, apo sjellje jo të kënaqshme profesionale të këshillohen me sygjerimit e nevojshme për përmirësimin e performancës në kuptim të realizimit të objektivave të përcaktuara në fillim të vitit.

Kolegji, mbi bazën e asaj që u theksua si më lartë e ka shfuqizuar r formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të ankuese për vitin 2021 i datës 31.01.2022, ndërsa udhëheqësi i drejtpërdrejtë me rastin e ri-vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesen duhet t'i ketë parasysh të gjeturat në këtë vendim si dhe të vlerësojë ankuesen vetëm për objektivat e caktuara në fillim të vitit, parakushte këto të cilat nuk janë sqaruar mjaftueshëm me rastin e dërgimit të shkresës me provat e lëndës me datë 18.03.2022 dhe në mungesë të cilave Këshilli nuk ka mundur të vendos nëse ankuesja është vlerësuar drejtë dhe në mënyre meritore, ndërsa meqenëse pretendimi ankimor i ankueses se vlerësimi i bërë nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik është konstatuar si pretendim i qëndrueshëm

në aspektin procedural të pasqyruar edhe në këtë vendim, prandaj lënda e ankueses kthehet në ri-shqyrtim me qëllim të ri-vlerësimit të rezultateve në punë për viti 2021.


Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.188/2022

Flakron GASHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHBANI



Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit/MASHT;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

